



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 117 Prot

Tiranë, më 30, 08, 2013

VENDIM QARKULLUES Nr. 268, datë 30, 08, 2013

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve Germani 1, Germani 2, Germani 3, Germani 4, në Lumin Mat (Komuna Komsj, Rrethi Mat) mbi bazën e kërkesës së Subjektit "SA'GA-MAT" sh.p.k., Tiranë,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve "Germani 1, Germani 2, Germani 3, Germani 4", në Lumin Mat (Komuna Komsj, Rrethi Mat), paraqitur nga Subjekti "SA'GA-MAT" sh.p.k., Tiranë.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Diber bazuar në kontratën dypalëshe midis "SA'GA-MAT" sh.p.k., dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori ("SA'GA-MAT" sh.p.k.) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Diber.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

VISAR ZHITI

MINISTËR

SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E  
SHËRBIMIT  
ARKEOLOGJIK